



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Regulativni Autoritet Železnica

Railway Regulatory Authority



Në bazë te nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullati të Hekurudhave miraton:

Rregulloren për Autorizim të Sigurisë Nr. 03/2012



Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Rregullorës është që sipas rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore, ARH si organ përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet të paraqesë procedurat dhe kriteret që duhet të plotësohen në procesin e aplikimit për Autorizim të Sigurisë, në menyrë që procesi të jetë i qartë dhe transparent.

Neni 2 Shtrirja

Kjo Rregullore është për operatoret ekzistuës dhe të ardhshëm të.

- Rrjetin hekurudhor dhe Infrastrukturen hekurudhore,
- Stacione dhe ranzhiruese,
- Depove të mirëmbajtjës për mjetet lëvizëse dhe mjetet tjera të mirëmbajtjës,
- Si dhe ndonjë kombinim i rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore, Stacioneve ranzhiruese, Depove të mirëmbajtjës për mjetet lëvizëse dhe mjetet tjera të mirëmbajtjës.

Kjo Rregullore do të ju ndihmojë që të paraqitni një aplikim të plotë me dëshmi mbështetëse. Kjo do të na ndihmojë te perpunojmë shpejt aplikimin tuaj. Kurë ju nuk i ndiqni procedurat tona ose kur nuk kemi kohë të mjaftueshme, ne mund të mos jemi në gjendje të ju japim autorizimin e sigurisë para datës suaj të planifikuar të fillimit.

Aty gjithshtu janë të përcaktuara obligimet tuaja në vazhdimësi.

Ne këtu mbulojmë vetëm qeshtjet e certifikimit të sigurisë. Pra ju duhet të merrni licencën për qasje para se të fillojnë operimet.

Ne inkurajojmë të gjithë që kanë nevojë për autorizim të sigurisë për të diskutuar me ne propozimet e tyre, para se të paraqesin kërkesë zyrtare.

Operimet Hekurudhore pa një certifikatë të sigurisë të pershtashme do të konsiderohet si vepër penale sipas Ligjit për Hekurudha. Ju duhet të vazhdoni të pershtateni me kushtet relevante të sigurisë, kur një autorizim i sigurisë është lëshuar.

Neni 3 Organi përgjegjës

ARH si organ përgjegjës i sigurisë është i pavarur kompetent për lëshimin e autorizimit të sigurisë në sektorin e hekurudhave në Kosovë.

Për me shumë informata ju lutem shiqoni faqen tone të internetit www.arh-ks.org.

Neni 4 Operatori

Si një operator, ju mund të jeni një individ, një kompani ose ndonje formë tjeter e organizimit. Për qëllime të autorizimit të sigurisë, ajo duhet të ketë një personalitet të veqant ligjor. Kështu, një pjesë ose individ brenda një kompanie nuk mund të jetë operator. Autorizimi i sigurisë normalisht nuk mund të mbahet nga një nivel i grupit, për kompanitë tjera ose njësive të atij grupei. Operatori mund të jetë i ndryshëm nga pronari.

Neni 5 Llojet e autorizimeve të sigurisë në Kosovë

1. ARH lëshon këto lloje të autorizimeve të sigurisë për menaxher të infrastrukturës hekurudhere në Kosovë:

- 1.1. Autorizimin e Sigurisë për funksionimin/operimin e rrjeteve hekurudhere dhe infrastrukturës hekurudhere (Autorizimi i Sigurisë A).
- 1.2. Autorizimin e Sigurisë për stacione hekurudhere dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) (Autorizimi i Sigurisë B).
- 1.3. Autorizimin e Sigurisë për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhere dhe mjetete tjera të mirëmbajtjes (Autorizimi i Sigurisë C).
- 1.4. Autorizimin e Sigurisë për operacione të kombinuara te rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhere, stacione hekurudhere dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese), mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhere (Autorizimi i Sigurisë D).

Neni 6 Qëllimi i autorizimit të sigurisë

Autorizimi i sigurisë autorizon operimin kudo në infrastrukturën e përdorimit të përbashkët në Kosovë vetëm nëse licencat përkatëse janë dhënë

Neni 7

Autorizimi i sigurisë e lëshuar nga vendeve tjera pjesa A e vlefshme në Kosovë

Ne pranojmë Autorizimin e sigurisë pjesa A e lëshuar nga një organ i sigurisë të Bashkimit Evropian (BE), pjesëmarrësve të SEETO, nënshkrues të Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit, dhe organeve të tjera të huaja sigurisë nëse ato përputhen me legjislacionin e Kosovës.

Pas pranimit të një autorizimi të tillë të sigurisë, pjesa A, ne duhet të njoftojm brenda tridhjetë (30) ditëve mbajtësin nëse autorizimi i sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Në rast se pjesa e juaj A është në përputhje me legjislacionin e Kosovës, ju duhet të aplikoni vetem për pjesen B.

Në rast se pjesa e juaj A nuk është në përputhje me legjislacionin e Kosovës, ju duhet të aplikoni vetem për pjesen A dhe B.

Neni 8

Vlefshmëria e autorizimit së sigurisë

Autorizimet standarte të sigurisë zakonisht kanë një vlefshmëri prej 5 viteve.

Neni 9

Bërja e një aplikimi

Ne dëshirojmë të përpunojmë aplikacionin tuaj dhe të marrim një vendim brenda tre (3) muajve mbas pranimit të te gjitha të dhënavë të kerkuar. Kjo kërkon bashkëpunimin tuaj të plotë. Ne kemi nevojë pér kohë të mjaftueshme pér te arritur në një vendim i informuar pér çdo aplikim. Nëse aplikacioni juaj nuk është i plotë dhe keni nevojë pér te bëre punë të metutjeshme, ju gjithashtu duhet të lejoni kohë pér ketë.

Ju duhet normalisht të lejoni të paktën tre (3) muaj në mes të bërjes së një aplikimi pér autorizim të sigurisë dhe kohës kur ju doni të filloni operimet. Ne nuk mund të lëshojmë autorizime të përkohshme të sigurisë pér të mbuluar operimet gjatë procesit të aplikimit. Ju nuk mund të filloni operimet derisa çdo autorizim i nevojshëm sigurie është dhënë, edhe në qoftë se ju keni marrë licencën.

Gjatë këtij procesi të aplikimit, ju duhet gjithashtu të përpinqeni pér të marrë çdo licencë, te nevojshme aprovimet ose lejet tjera (patentat e vozitjes, etj.). Ju duhet të lejoni kohë më gjatë nëse aplikimi juaj është i ndërlikuar, shtron çështje të reja, apo ka të ngjarë të rezultojë më shqetësimë nga ana e palëve të tjera.

Megjithatë, ju lutem mos aplikoni shumë herët ose spekulativisht se situata mund të ndryshojë, ose ne mund të vendosim pér të kthyer aplikimin tuaj. Afati kohor mund të diskutohet me ne në një takim paraprak.

Neni 10

Formulari i aplikimit për autorizim të sigurisë

Për të aplikuar për një certifikatë të sigurisë ju duhet të perdorni formularët e veçantë të aplikimit të ofruar nga ana e jonë. Ato mund të gjenden në faqen tonë të internetit www.arh-ks.org. Këta formularë kërkojnë informacionin minimal të nevojshëm për të filluar përpunimin e aplikacionit tuaj.

Ju mund të dergoni formularët e aplikimit me e-mail.

Është vepër penalë që te bëhet një deklaratë për ne nëse ju e dini se është e rrejshme, ose në mënyre të pakujdesëshme të bëhet ndonjë deklaratë që është e rrejshme.

Ne do të ju njoftojmë për marrjën e aplikacionit tuaj brenda 48 orëve, dhe me emrin e personit të caktuar për rastin tuaj.

Neni 11

Procedurat

Ne mund të ngrisim ndonjë shqetësim të menjëhershëm në lidhje me aplikacionin, nëse paraqitet ndonjë.

Ne do të kontrollojmë aplikacionin tuaj se a është i plotë dhe për tu siguruar se kemi informatat e mjaftueshme. Atëherë do të marrim një vendim fillestar se a të pranohet apo jo aplikacioni. Nëse mendojmë se një aplikacion nuk duhet të pranohet, normalisht ne duhet t'ju japim edhe katër (4) javë tjera kohë që të paraqitni qëndrimet tuaja para se të merret vendimi përfundimtar.

Rrallë ndodhë që ne të kthejmë aplikacionet në atë mënyrë, por një gjë e tillë mund të ndodhë. Arsyet mund të janë se ju nuk ofroni informata të bollshme apo në rast se operimi juaj nuk do të fillojë brenda 9 muajsh pasi të keni marrë certifikatën e sigurisë dhe brenda 18 muajsh prej kur të keni marrë autorizimin e sigurisë.

Neni 12

Përjashtimet e Autorizimit të sigurisë

Fillimisht ju duhet të kontrolloni nëse tashmë keni ndonjë përjashtim nga sistemi i Autorizimit të sigurisë.

Nuk ekziston ndonjë tarifë për procesimin e kërkesave për përjashtim nga Autorizimi i sigurisë. licanca. Ju lutem përfshini hartat apo planet e operacioneve tuaja nëse është e mundur.

Neni 13 Diskutimet joformale

Ne mirëpresim qasjet jo-formale në fazë të hershme para aplikimit.

Ne mund të shpjegojmë kërkesat tona që duhet përmبushur, mund të ndihmojmë në identifikimin e çështjeve tjera rregullatore dhe të diskutojmë afatet kohore. Edhe pse ne mund të jepim udhëzime të hershme në mënyrë joformale, opinioni ynë mund të ndryshojë kur ne shqyrtojmë aplikacionin tuaj të parashtruar formalisht. Mirëpo udhëzimi në një fazë të hershme mund të jetë i vlefshëm, u kursen kohë dhe shpenzime.

Neni 14 Kriteret e sigurisë

Në vlerësojmë aplikimet në bazë të kritereve për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë, siq janë përcaktuar në Ligjin e Kosovës për hekurudhat dhe në Rregulloren e Komisionit 1158/2010/KE.

Neni 15 Konfidencialiteti

Ne jemi të përkushtuar të hapur dhe transparent, por ne vlerësojmë se gjatë një aplikimi ne mund të marrim informacion që është i ndjeshëm komercial. Ju duhet të kërkoni nga ne që ta trajtojmë informacionin e ndjeshëm komercial si “konfidencial”. Ju lutem tregoni qartë se ku është ky rast.

Ne duhet të publikojmë disa informata të caktuara në lidhje me aplikantët dhe operimet e propozuara, në faqën tonë të internetit gjatë fazës së hershme të konsultimeve ligjore

Neni 16 Njoftimi

Ne do të njoftojmë Ministrinë e Infrastrukturës kur ne të kemi marrë një vendim për dhënien e autorizimit të sigurisë apo për të njojur certifikatën e sigurisë të lëshuar nga vendet të tjera, pjesa A.

Njoftimi do të publikohët në faqën tonë të internetit. Kopjet gjithashtu do të ju dërgohen ju.

Neni 17
Jo diskriminimi

Nëse ju besoni që do të diskriminohen apo të trajtoheni padrejtësisht apo në ndonjë mënyrë tjetër jeni të dëmtuar me vendimin tonë, ju keni të drejtë të bëni një ankesë në ARH si një organ i apelit.

Neni 18
Zbatimi

Ne jemi kompetent për zbatimin e kushteve të autorizmit të sigurisë dhe për të hetuar përbajtjen e kritereve të autorizmit të sigurisë, pasi që qëllimi i zbatimit të autorizmit të sigurisë është të sigurojë shpërndarjën dhe përputhshmërinë me detyrimet e interesit publik.

Nëse nuk veproni në përputhje me obligimet e autorizmit të sigurisë ne do të shqyrtojmë veprimet zbatuese. Kjo përfundimisht mund të rezultojë në pezullim apo revokim të autorizmit tuaj të sigurisë.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore duhet të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Halit Gara,
Kryetari i Bordit

Prishtinë, 23.08.2012

